



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Study program Gjuhë dhe Letërsi Shqipe (2020/2021)

Fakulteti	Gjuhët, Kulturat dhe Komunikimi
Cikli i studimeve	Cikli i tretë (doktoratë)
SETK	180
Titulli	Doktor i shkencave filologjike - Drejtimi: Gjuhë shqipe / Letërsi shqipe
Numri në arkiv i akreditimit [180]	03-3074/1
Vendimi për fillim me punë	
Data akreditimit	16.10.2020

Përshkrimi i programit

Programi studimor gjuhë dhe letërsi shqipe i ciklit të tretë (studimet e doktoratës), është dizajnuar me qëllim që studentët të cilët do të përfshihen në këtë program të fitojnë njohuri që i afrojnë kah profesionet të cilat janë të lidhura ngushtë me sferën e gjuhës, kulturës, letërsisë dhe arsimit. Njëherësh studentët fitojnë shkathtësi dhe kompetenca për punësim në nivele më të larta të sektorit publik dhe privat.

Karriera

Studentët e doktoruar nga ky program studimor do të mund të punësohen në fusha të shumta të jetës shoqërore dhe profesionale. Mësimdhënie: në shkollë të gjuhës dhe letërsisë, në gjimnaze, në shkollë fillore dhe të mesme, profesorë universitarë. Punësim: gjuhëtarë, gazetarë nga sfera e letërsisë dhe artit, në ndërmarrje të ndryshme si lektorë, përkthyes dhe interpretues të gjuhës dhe letërsisë shqipe në ministri dhe institucione të tjera qeveritare, përkthyes/interpretues në gjyqe dhe institucione të tjera të ngjashme, përkthyes/interpretues në organizatat profesionale, përkthyes/interpretues në sektorin shoqëror dhe atë privat, përkthyes/interpretues në organizata ndërkombëtare

Rezultatet e të mësuarit

Njohuritë dhe të kuptuarit

Me këtë program studimor kandidati fiton njohuri të përgjithshme për shumë fusha gjuhësore dhe letrare, siç janë ato njëdisiplinare dhe interdisiplinare. Me këto studime ai fiton njohuri më të reja dhe të rëndësishme bashkëkohore, që do t'i mundësojë të jetë më kreativ dhe më profesional në zgjidhjen e problemeve gjuhësore dhe letrare.

Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit

Korpusi i njohurive i mundëson studentit të ciklit të tretë punësime të ndryshme që përfshijnë sektorë të shumtë dhe të llojllojshëm të jetës shoqërore dhe profesionale. Njohuritë mund të zbatohen në mësimdhënie duke punuar si profesor në shkollat e mesme dhe si asistent në fakultetet dhe institutet përkatëse; studenti mund të punojë si studiues dhe hulumtues nga fusha e gjuhësisë dhe e letërsisë në institutet e ndryshme albanologjike; mund të punojë si gazetar, në fushën e

letërsisë dhe artit, redaktor dhe lektor, por edhe si kritik letrar dhe gjuhësor në media të ndryshme elektronike dhe të shkruara, ku mund të japë kontribut për çështjen e zbatimit të normës letrare; mund të punojë si përkthyes dhe interpretues i gjuhës dhe letërsisë shqipe në komunat dygjuhësore, nëpër ministri dhe në institucionet tjera qeveritare, në gjyqe dhe institucione tjera të ngjashme, në organizatat profesionale, në sektorin shoqëror dhe atë privat, në organizata ndërkombëtare etj.

Aftësitë për të vlerësuar

Janë të aftë për të hartuar dhe për të vlerësuar planet dhe programet mësimore nga fusha e gjuhësisë për shkollat e mesme dhe universitare. Janë në gjendje të organizojnë dhe vlerësojnë mbajtjen e orëve mësimore nga fusha e gjuhësisë dhe letërsisë. Kanë aftësi për të vlerësuar dhe krahasuar përkthimet nga një gjuhë në gjuhën tjetër. Vlerësojnë redaktimin dhe lektorimin e teksteve të ndryshme gjuhësore, letrare dhe publicistike, duke vlerësuar shkallën e lartë të redaktimit duke i gjetur gabimet eventuale gjuhësore. Janë të aftë për të vlerësuar një vepër nga aspekti kompozicional dhe përmbajtësor, duke veçuar vlerat gjuhësore dhe letrare. Kanë predispozita për t'u bërë anëtarë në ndonjë juri profesionale nga fusha e gjuhës dhe letërsisë, për të vlerësuar studimet më të mira gjuhësore dhe letrare. Kanë aftësi për t'u kyçur në ekipe hulumtuese, duke hartuar tekste letrare, publicistike, fjalorë, leksikorë dhe fjalorë tjerë të ndryshëm.

Aftësitë e komunikimit

Doktorët e rinj të shkencave kanë shkathtësi profesionale për të mbajtur orë mësimore nga letërsia dhe gramatika e gjuhës amtare në përputhshmëri me planet dhe programet për shkollat e mesme dhe universitare. Mund të mbajnë kurse për mësimin e gjuhës dhe letërsisë shqipe për të huajt. Mund të përkthejnë vepra shkencore, letrare dhe gjuhësore nga gjuhët në kontakt në gjuhën amtare dhe anasjelltas. Mund të marrin pjesë në simpoziume dhe seminare vendore dhe ndërkombëtare, ku me kumtesat e tyre arrijnë të paraqesin rezultate origjinale nga hulumtimet që ka bërë në disiplina të ndryshme letrare dhe gjuhësore. Janë të aftë të shkruajnë recensione për vepra të botuara nga fusha e letërsisë dhe e gjuhësisë, pastaj edhe recensione për botimin e studimeve letrare dhe gramatikave siç janë tekstet mësimore. Mund të bëjnë hulumtime të pavarura dhe të marrin përgjegjësi për rezultatet e kumtuara. Mund të botojnë artikuj shkencorë dhe vepra nga fusha e letërsisë dhe gjuhësisë.

Aftësitë e të mësuarit

Kanë aftësi të zgjidhen asistentë në institutet albanologjike dhe të ndihmojnë në ekspeditat shkencore. Mund të paraqiten si udhëheqës në projekte të caktuara nga fusha e letërsisë dhe gjuhësisë dhe të bëjnë ndryshime në institucione të ndryshme. Për të arritur rezultate më të mira mund të prezantojnë njohuri të reja, mund t'i trajtojnë të tjerët, duke mbajtur kurse në lëmenj të caktuar, si në: drejtshkrim, redaktim gjuhësor të tekstit letrar, përdorim të metodave dhe teknologjive të reja për mësimdhënie etj. Mund të mbajë trajnime lidhur me përgatitjen e një projekti, shkrimin e një punimi shkencor etj. Mund të propozojnë risi për t'i plotësuar mangësitë e institucionit përkatës, siç janë: hapja e seksioneve të ndryshme nga letërsia dhe gjuha, hapja e bibliotekës, promovimi i ndonjë veprë letrare dhe gjuhësore etj. Mund të propozojnë metoda të reja për mësimin e shqipes sipas niveleve, për të huajt. Gjithsesi, duhet ta vazhdojnë arsimimin e mëtejshëm dhe të pajisen me njohuri të reja, të cilat t'i prezantojnë përsëri në institucionin ku punojnë, por edhe jashtë tij.

Lista e lëndëve

Semestri 1

- [DLCC0101] [10.0 SETK] **Metodologjia e hulumtimit**
- [DLCC0102] [10.0 SETK] **Çështjet kyçe në mësimdhënien e gjuhës dhe letërsisë**
- [DLCC0103] [10.0 SETK] **Shkrimi i disertacionit të doktoratës**

Semestri 2

- [DLCC0104] [10.0 SETK] **Shqyrtimi dhe miratimi i planit të disertacionit të doktoratës**
- [10.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [10.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**

Semestri 3

- [PHD-S3-S4-01] [40.0 SETK] **Punë kërkimore-shkencore**
- [PHD-S3-S4-02] [15.0 SETK] **Publikime I**

- [C2019] [5.0 SETK] **Mobiliteti i studentëve**

Semestri 4

Semestri 5

- [DLCC0105] [20.0 SETK] **Prezantimi i rezultateve të hulumtimit**
- [PHD-S5-01] [10.0 SETK] **Publikime II**

Semestri 6

- [ALL-PHD-THESIS] [30.0 SETK] **Disertacioni i doktoratës**

Description of courses

Lëndë obligative

- **Metodologjia e hulumtimit**

Kjo lëndë ka për qëllim të shpjegojë metodologjitë dhe teknikat e punës shkencore, të cilat kryesisht studentëve u krijojnë shumë vështirësi. Ushtrimet praktike do t'u ndihmojnë studentëve të orientojnë në bibliotekë, të shkruajnë një punim shkencor, referate, punime seminarike etj.. Në kuadër të këtij kursi do të përfshihen temat si: përcaktimi i temës, bibliografia, rregullat e citimit, kodet shkencore, organizimi i punës etj.

- **Çështjet kyçe në mësimdhënien e gjuhës dhe letërsisë**

Kjo lëndë ka për qëllim të njohë doktorantët me disa kapituj të rëndësishëm të linguitikës aplikative. Lënda ka funksion komunikues të gjuhës në të gjitha sferat e praktikës sociale, në aspektin e përdorimit të rezultateve të fituara në praktikë. Në detyrat klasike të linguitikës aplikative përfshihet studimi i gjuhës, linguitika kontrastive - kjo do të thotë krahasimi i gjuhës gjermane me shqipen dhe maqedonishten, komunikimi ndërkulturore, përkthimet dhe interpretimet profesionale, gjuha e terminologjisë profesionale. Nëpërmjet kësaj linguitika aplikative studion komunikimin e përgjithshëm dhe profesional në institucione dhe media etj. Përveç kësaj do të trajtohen edhe disa tema nga sfera e letërsisë gjermane.

- **Shkrimi i disertacionit të doktoratës**

Lënda është dizajnuar për t'i aftësuar studentët që të bëjnë në mënyrë të pavarur hulumtime shkencore gjegjësisht për të shkruar punimin e doktoratës . Është paraparë që ky kurs të jetë praktik dhe t'ju japë studentëve njohuritë, mundësinë dhe besimin e duhur për t'iu qasur me sukses hulumtimit të tyre shkencor. Për këtë arsye lënda më shumë është bashkëpunim se sa një lëndë që në mënyrë strikte bazohet në leksione. Nga studentët pritet që të marrin pjesë në mënyrë aktive në diskutime.

- **Shqyrtimi dhe miratimi i planit të disertacionit të doktoratës**

Pas semestrit të parë, studenti fillon aktivitetet e tij për përpilimin e planit mbi disertacionin e doktoratës. Aktivitetet përfshijnë përcaktimin e literaturës, përcaktimin e kornizës hipotetike, përkufizimin e metodologjisë së punës dhe përcaktimin e planit individual si dhe prezantimin e parë publik.

- **Punë kërkimore-shkencore**

Në vitin e dytë (semestri 3 dhe 4) kandidati vazhdon me veprimtarinë kërkimore shkencore sipas planit individual të miratuar. Mentori siguron vlerësimin lidhur me këto aktivitete në formën e një raporti drejtuar Këshillit mësimor-shkencor të fakultetit.

- **Publikime I**

Publikimi i aktiviteteve kërkimore-hulumtuese sipas tabelës me rëndësi për mediat për publikim. Aktivitetet dhe sukseset publicistike të kandidatit kontrollohen para audiencës shkencore sipas lëmit dhe relevancës së hulumtimit.

- **Mobiliteti i studentëve**

Gjatë semestrit të katërt studenti është i detyruar të realizojë mobilitet në një institucion shkencor, ose institucion tjetër relevant për fushën e kërkimit jashtë vendit në një kohëzgjatje prej të paktën një javë. Qëllimi i mobilitetit të

doktorantëve është të prezantojnë, shkëmbejnë dhe diskutojnë punën e tyre kërkimore me kolegë nga vende të tjera për të përmirësuar cilësinë e disertacionit të tyre. Për realizimin e mobilitetit studenti sjell dëshmi nga institucioni, të cilën ia dorëzon mentorit.

- **Prezantimi i rezultateve të hulumtimit**

Në fund të semestrit të 5-të, pas aktiviteteve kërkimore-hulumtuese sipas planit individual, kandidati do t'i prezantojë publikisht rezultatet e përgjithshme të kësaj faze të punimit dhe të hulumtimit. H

- **Publikime II**

Publikimi i aktiviteteve kërkimore-hulumtuese sipas tabelës me rëndësi për mediat për publikim. Aktivitetet dhe sukseset publicistike të kandidatit kontrollohen para audiencës shkencore sipas lëmit dhe relevancës së hulumtimit.

- **Disertacioni i doktoratës**

Vazhdimi i punës së disertacionit të doktoratës. Dorëzohet teza (disertacioni), pranohet nga Këshilli mësimor-shkencor i fakultetit, u dorëzohet anëtarëve të komisionit dhe fillon procedura e mbrojtjes publike.

Lëndë zgjedhore

- **Studimet e gramatikës së gjuhës shqipe**

Lënda Studimet e gramatikës së gjuhës shqipe, ngërthen në vete një materie shumë të zgjeruar mbi konceptin e gjuhës ku hyjnë: fonetika, leksikologjia, morfologjia e sintaksa. Koncepti bazë i studimeve të kësaj materie për shkallën e doktoratës është diç më specifik, pasi përkapen tema që janë më të ngjeshura, ku flitet për gramatikën jo vetëm si koncept, por edhe si shkencë ku konceptohen parimet e një gjuhe në të folmen e saj standarde. Qëllimi i kësaj materie është që të pajisen përgjithësisht studentët doktorantë me vlera kulturore, krahasuese e standardizuese.

- **Studimet e letërsisë shqiptare - proza**

Lënda trajton zhvillimin e prozës bashkëkohore shqipe, kthesat e saj dhe prodhimin cilësor në kohën e tashme, kulturen e së bukurës në art, fillimin e një epoke të re, kulmimin e vlerave artistike e letrare, përcaktimin dhe nominimin e koncepteve stilistike letrare.

- **Sociolinguistika dhe gjuha e arsimit**

Kjo lëndë synon të familjarizojë studentët me konceptet themelore dhe tema të sociolinguistikës si: varietetet e gjuhës, variacionin gjuhësor dhe ndryshimin, variablat e të folurit, rrjetit shoqëror dhe të folurit në komunitet, analizë të diskursit dhe etnografinë e komunikimit, si dhe gjuhën dhe gjininë. Kjo lëndë, fokusohet në ndryshimin e sistemeve gjuhësore dhe në rolin e folësit në zbatimin dhe ndryshimin e shpërndarjes gjuhësore. Implikimet e këtyre ideve për fusha të tilla si gjuha dhe arsimit janë diskutuar. Do të konsiderohen edhe aplikimet e mëposhtme të sociolinguistikës: politika gjuhësore dhe e planifikimit; ndër-marrëdhëniet midis gjuhës dhe shoqërisë; kontakti i gjuhës; kërkimet aktuale, debatet dhe idetë nga traditat e ndryshme brenda sociolinguistikës.

- **Kritika letrare Л**

Kjo lëndë përmban njoftim me studimet themelore letrare – si duhet të lexohet dhe të kuptohet e mësohet kritika bashkëkohore letrare shqipe. Përmes saj studiohet marrëdhënia ndërmjet letërsisë, historisë e politikës dhe mendimit kritik si teori kritike e rëndësishme.

- **Teoria e letërsisë**

Ky modul synon të mbulojë një gamë të konsiderueshme të qasjeve kritike dhe teorike për studimet letrare dhe filmit, duke përfshirë punën e autorësisë, tekste dhe lexim, ideologji dhe pushtet, gjininë, seksualitetin, racën, vendin dhe postkolonializmit. Kursi do të ndjekë ndryshimin në diskursin teorik të perspektivave humaniste liberale në fillim të shekullit të njëzetë dhe format e ndryshme të post-strukturalizmit dhe postmodernizmit. Teoritë e diskutimit do të përfshijnë dekonstrukcionin, varietetet e feminizmit, teoritë e "të tjerëve" dhe diskurset postkoloniale, vdekjen e autorit dhe teoritë së pritjes lexues. Moduli i inkurajon studentët të pranojnë dhe njohin dialogun dhe mosmarrëveshjet brenda fushës, dhe fut rregullat themelore të bursës në disiplinën e studimeve letrare.

- **Folklori**

Është një materie mjaft e pasur dhe e thuktë nga folklori shqiptar dhe ai popujve të tjerë, përmes së cilës veçohet me vlerat e mëdha të kulturës shpirtërore, të trashëguara nga gjeniu popullor, vlera këto që dëshmojnë për bukurinë e krijimtarisë popullore dhe për fuqinë krijuese poetike të krijuesve anonimë, për aftësitë krijuese të tyre në sferat e artit, i cili pasqyron qartë e bukur të kaluarën historike të popullit shqiptar dhe popujve të Ballkanit.

- **Multikulturalizmi**

Qëllimi i kësaj lënde është shqyrtimi i shumëgjuhësisë në shoqëritë multikulturore, si fenomen social. Ky fenomen është masiv në mbarë botën. Gjatë ligjëratave në mënyrë më të thuktë do të shqyrtohen termit: monokulturalizëm, shumëkulturalizëm, multikulturalizëm. Do të sqarohet nocioni nacionalizmi lingvistik, ku do të theksohet se të paktën ka dy forma të këtij nacionalizmi, ku njëra formë përplasat me tjetrën: për udhëheqësit e vendeve më të fuqishme nacionalizmi ka domethënien e zgjerimit, kurse për pakicat ai merr formën e rezistencës dhe të luftës për afirmimin e identitetit, përballë një presionit të tillë. Vend të shquar në programin e ciklëit të tretë do të ketë edhe multikulturalizmi në arsim. Në studimet e këtij cikli për multikulturalizmin në këtë program mësimor përfshihen përmbajtje që u përkasin kulturave të ndryshme.

- **Komunikimi ndërkombëtar**

Lënda përqendrohet në zhvillimin e atyre shkathtësive të komunikimit ndërkombëtar që janë thelbësore për funksionimin efektiv në botën profesionale. Studentët do ta mësojnë procesin e analizimit të një shumëllojshmërie situatash të komunikimit ndërkombëtar dhe t'u japin përgjigje adekuate po atyre. Ndër temat që do të përfshihen janë: komunikimi ndërkombëtar, në organizata, komunikimi ndërpersonal dhe grupor, prezantimet gojore, intervistat për punësim, letrat profesionale të biznesit, si dhe shkathtësitë ndërpersonale, duke përfshirë dinamikën e grupit dhe punën ekipore.